



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 223/Prot.
3

Tiranë, më 10.02.2022

VENDIM

Nr. 12, datë 10.02.2022

PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMET E
STUDIMIT TË CIKLIT TË OFRUARA NGA UST PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Mbështetur në neni 23, 38, 74, 76 të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”; në vijim të shkresës së MAS nr.171 Prot., dt.12.1.2022 “Për publikimin e kriterëve të pranimit për vitin akademik 2023-2024, si dhe Vendimit të Rektoratit nr.9, datë 08.02.2022, Senati në mbledhjen e tij të datës 10.02.2022,

VENDOSI

1. Miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë për vitin akademik 2023-2024 pranë FSHL, FVFR dhe FSHR si vijon:
- **FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES**
A- Për ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në programin e studimit “Shkencat e Lëvizjes”
 1. Pranohen kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe kur kanë kryer jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare.
 2. Pranohen kandidatët që zotërojnë diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit, por pasi të jetë bërë ekuivalentimi i diplomës së fituar në vendin e huaj nga MAS.
 3. Pranimi në programin “Bachelor” është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson:
 - Kriterin e meritës (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
 - Kriteret e vendosura për konkursin e pranimit. (testet e miratuara nga Senati i UST-së dhe të shpallura në Web-in zyrtar të Universitetit).

- Kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore të miratuara nga UST-ja dhe të shpallura në Web-in e UST-së.

B- Për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional” në programin e studimit “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”.

1. Proçesi i pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”, zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke respektuar ushëzimet e MAS, si dhe proçedurën e përshkruar në Rregulloren e UST-së.
2. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë Master në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar” kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “**Bachelor**” pranë UST^{sc} apo IAL-ë të tjera të ngjashme me të, dhe të plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara në Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit.
3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve do të jetë ai i notës mesatare.
4. Renditja e aplikantëve bëhet në bazë të mestares të ponderuar të ciklit të parë studentëve të diplomës “**Bachelor**”/DNP, si dhe në përputhje me kriteret e tjera të vendosura nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, ku përzgjedhja e studentëve bëhet sipas kriterit të meritës nga lart poshtë brënda kuotave të miratuara. Kriteret e vlerësimit dhe përzgjedhjes së studentëve të ciklit të dytë të studimeve janë si më poshtë:
 - Kriteri i meritës (nota mesatare e studimeve “Bachelor”)
 - Kriteri i rëndësisë (koeficienti i profilin të studimeve “Bachelor” sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit të FSHL^{sc})
 Përzgjedhja e kandidatëve fitues (**F**) në programin e ciklit të dytë do të jetë e përlogaritur si më poshtë:

$$F = N \times K$$

Ku: **N** – Nota mesatare në “Bachelor”

K – Koeficienti i rëndësisë i cili përcaktohet sipas profilin dhe programin të studimit që konkurenti ka përfunduar.

5. Kanë prioritet aplikantët që kanë përfunduar ciklin “**Bachelor**” në të njëjtën fushë në UST-së, sipas një skeme vlerësimi të përcaktuar në Rregulloren e sipërpërmëndur të Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit.
6. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të njëjta studimi ose të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë “**Bachelor**”, të shprehur në kredite është jo më pak se 70%, pranohen pa kredite debi në programin e studimit të ciklit të dytë Master në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”.
7. Për rastet që nuk plotësojnë kriterin e pikës 6, Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit përcakton disiplinat bazë dhe karakterizuese që duhet të japë kandidati, në funksion të njohurive pararendëse që duhet të ketë studenti, për të ndjekur programin e studimit Master

në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”. Numri total i krediteve shtesë për plotësimin e njohurive të tyre nuk duhet të jetë më i madh se 30 kredite/etc. Detyrimet që i linden aplikantit të shpallur fitues, kur vijnë nga fusha të tjera studimi të përafërta i komunikohen aplikantit përpara regjistrimit të tij.

8. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të njëjta studimi ose të përafërta në rast se do të rezultojnë vende të mbetura bosh do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve “**Bachelor**” në IAL-ët e tjera brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi i kandidatëve do të bëhet mbi bazën e notës mesatare sipas rendit zbritës.
9. Kandidatë, të cilët aplikojnë për program të dytë studimi klasifikimi i tyre do të bëhet mbi bazën e notës mesatare sipas rendit zbritës.
10. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në UST-së, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

C- Për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional” në programin e studimit “Trainer i përgatitjes fizike”

1. Në programin Master Profesional “Trainer i përgatitjes fizike” pranohen kandidatët të cilët minimalisht plotësojnë një diplomë “Bachelor” të përfituara në një nga programet e ofruara së UST-së pranë FSHL-së ose FVFR-së.
2. Gjithashtu pranohen në këtë program studimit të gjithë kandidatët që vijnë nga IAL të tjera dhe që zotërojnë diploma ekuivalente me ato të ofruara në UST sipas pikës 1.
3. Studentët që kandidojnë për këtë program studimit dhe që diploma e tyre ka përputhshmëri më të vogël se 70% e programeve të ofruara në UST, pranohen të regjistrohen në këtë program me debi kreditesh duke i plotësuar ato sipas një plani kurrikulor, të ndërtuar nga departamenti që ofron këtë program studimi.
4. Renditja e kandidatëve bëhet sipas kriterit të meritës (notës mesatare) dhe diplomës paraprahe të fituar në UST dhe jashtë saj.

D- Për ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Shkenca Sportive

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për programin e studimit të ciklit të dytë *Master i Shkencave në “Shkenca Sportive”*, kandidatët që:
 - a. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezultoi i akredituar në momentin e diplomimit të studentit.
 - b. Jane diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.

2. Në studimet e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Sportive”, pranohen:

a) Pa njohuri plotësuese, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:

- Diplomuar në një nga programet Bachelor të ofruara në UST.
- “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes”, “Fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndetit dhe të Rekreacionit”, në universitete të tjera.
- Diplomë e Niveli të Parë në fusha të ngjashme.
- Nga fusha të njëjta të përafërta ose të ndërlidhura me Shkencat Sportive, ku përfshihen:
- Diplomat e ciklit të parë të integruara
- Master në Shkencat Mjekësore

b) Me plotësim të njohurive,

Studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:

- “Bachelor” ose Diplomë e Niveli të Parë nga fusha të tjera dhe që kanë interesa në studim të Shkencave Sportive pranohen në plotësim të njohurive në disiplinat e Mjekësisë Sportive (Fiziologji, Anatomí, Biologji) dhe Biomekanikë.

3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i çertifikatës së fituar.

Nëse individ i ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

4. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë. Ky kriter do të jetë i rivlerësueshëm çdo vit akademik, në varësi të studentëve konkurrues.

• **FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT**

- **Për ciklin e parë të studimeve Bachelor “Fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndetit dhe të Rekreacionit”**

1. Kanë të drejtë të pranohen në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor “Fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndetit dhe të Rekreacionit” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm (Maturën Shtetërore në RSH), ose ekuivalentin e saj për shtetasit që kanë studiuar në vende të tjera.

2. Kandidatët i nënshtrohen konkurimit praktik konform testeve të miratuara nga Senati i UST dhe të shpallura në faqen ëeb të UST.

3. Raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe mesatares së kandidatit të jetë 70% me 30%. Për kandidatët që konkurojnë për të hyrë në ciklin e parë “Bachelor”, duhet që të grumbullojnë minimumi 10 (dhjetë) pikë nga 70 (shtatëdhjetë) të mundshme të konkurimit praktik.
4. Kandidatët që konkurojnë në këtë program studimi, duhet të plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore miratuar nga UST dhe e shpallur në faqen ëeb të saj.

- **Për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi”**

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “Bachelor” pranë FVFR apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve të shpallura në faqen ëeb të UST.
3. Klasifikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit e cila gjendet në faqen zyrtare të UST-së.

- **Për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”**

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e ciklit të dytë Master në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë Bachelor.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve të shpallura në faqen ëeb të UST.
3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i formimit në ciklin e parë të studimeve dhe ai i notës mesatare më të lartë.

- **Për ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”**

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e ciklit të dytë Master Shkencor “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”, të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në parë Bachelor pranë FVFR apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST, konform afateve të shpallura në faqen ëeb të UST.
3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i notës mesatare më të lartë.

4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar ciklin e parë Bachelor në sistemin me kohë të plotë dhe part time të FVFR.
5. Në rastet kur rezultojnë vende të mbetura bosh, do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë Bachelor në IAL të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare më të lartë.
6. Do të pranohen kandidatët të cilët kanë të mbrojtur një nga gjuhët e huaja në programet e njohura nga MAS.

- **FAKULTETI SHKENCAVE TË REHABILITIMIT**

Për ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në programin e studimit “Shkencat e Rehabilitimit”

I. Kandidatet që aplikojnë për pranim në programin e studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” që ofron Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit pranë Universitetit të Sporteve të Tiranës për vitin akademik 2022-2023, duhet të ketë notën mesatare minimale si më poshtë:

- Shkencat e Rehabilitimit ≥ 6.5

*Nota mesatare minimale përllogaritet si mesatare aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm dhe mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të maturës shtetërore.

Kriteret e pranimi të studentëve në programin e studimit të Ciklit të Parë “Bachelor” për vitin akademik 2023-2024, përbëhet nga:

1. Nota mesatare aritmetike e provimeve të Maturës Shtetërore 40%, ku:
 - a) Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje: Kimi, Fizike, Biologji, nota e provimit shumëzohet me 1.4.
 - b) Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje, të ndryshme nga lëndët e përcaktuara në pikën a) të sipërcituar, nota e provimit shumëzohet me koeficientin 1.
2. Nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme (për të gjitha vitet) 30%
3. Nota mesatare aritmetike e lëndëve fornuese (**Fizikë, Kimi dhe Biologji**), të zhvilluara gjatë tri viteve të shkollës së mesme 30%, ku (lëndët, **Fizikë, Kimi dhe Biologji** të vitit të tretë, shumëzohen me koeficient 1.25):
 - a) Fizike 10%;
 - b) Biologji 10%;
 - c) Kimi 10%;

Bashkëlidhur në formë të përmbledhur tabela nr. 1, për pikën I dhe II/1.2.3

III. Koeficientët sipas llojeve të shkollave të mesme që do të aplikohen për vlerësimin e kandidatëve që aplikojnë për programet që ofron Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit janë sipas tabelës nr. 2.

IV. Formula e përlogaritjes së pikëve për kryerjen e procesit të renditjes së kandidatëve që do të aplikojnë në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit, për vitin akademik 2023-2024, do të jetë si më poshtë vijon:

$$PP = \{((M1 * 30) + ((NF1 + NF2 + NF3 * KLZ)/3) * 10 + ((NB1 + NB2 + NB3 * KLZ)/3) * 10 + ((NK1 + NK2 + NK3 * KLZ)/3) * 10 + ((D1 + D2 + D3 + Z1 * KZ1)/4) * 40\} * KSHM * 100$$

Shpjegim:

PP	Pikë të përgjithshme për renditje
M1	Nota mesatare aritmetike e thjeshtë për të gjitha vitet e shkollës së mesme;
NF1	Nota përfundimtare e lëndës Fizikë në vit të parë;
NF2	Nota përfundimtare e lëndës Fizike në vit të dytë;
NF3	Nota përfundimtare e lëndës Fizike në vit të tretë;
NB1	Nota përfundimtare e lëndës Biologji në vit të parë;
NB2	Nota përfundimtare e lëndës Biologji në vit të dytë;
NB3	Nota përfundimtare e lëndës Biologji në vit të tretë;
NK1	Nota përfundimtare e lëndës Kimi në vit të parë;
NK2	Nota përfundimtare e lëndës Kimi në vit të dytë;
NK3	Nota përfundimtare e lëndës Kimi në vit të tretë;
KLZ	Koeficienti i lëndëve me zgjedhje të vitit të tretë, Kimi, Biologji, Fizike, nota shumezohet me koeficient 1.25;
D1	Provimi i detyruar i maturës 1;
D2	Provimi i detyruar i maturës 2;
D3	Provimi i detyruar i maturës 3;
Z1	Provim me zgjedhje i maturës 1;
KZ1	Koeficienti i lëndës me zgjedhje në maturën shtetërore dote jete si me poshte: • Provime mature me zgjedhje, lëndët Kimi, Fizikë, Biologji, KZ =1.4 • Të gjitha lëndët e tjera KZ= 1
KSHM	Koeficienti i shkollës së mesme, sipas tabelës nr. 2. bashkëlidhur këtij vendimi

Tabela Nr. 1: Kriteret e pranimit në formë të përmbledhur për programet e studimeve të ciklit të parë në Universitetin e Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, për vitin akademik 2023-2024.

Universiteti/ Fakulteti	Cikli i studimit Bachelor/Master	Emërtimi i programit	Nota mesatare sipas VKM	Pesha në % e notës mesatare të shkollës së mesme për të gjitha vitet e studimit	Pesha në % e notës mesatare e provimeve të Maturës Shtetërore	Mesatarja aritmetike e lëndëve formuese për të tri vitet	Lëndët me zgjedhje (të vitit të tretë) dhe koeficienti që shumëzon çdo lëndë
Universiteti i Sporteve të Tiranës Fakultetit i Shkencave të Rehabilitimit	1	Shkencat e Rehabilitimit	≥ 6.5	30 %	40 %	30 %	Kimi, Biologji, Fizikë (Nota e vitit të tretë *koeficienti 1.25) Për lëndët e tiera, nota llogarritet = 0

Tabela Nr. 2: Koeficientët sipas llojit të shkollës së mesme që kanë përfunduar kandidatët, të cilët aplikojnë në Universitetin e Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, për vitin akademik 2023-2024:

Nr	LLOJI I SHKOLLE SE MESME	KOEFIÇIENTI
1	GJIMNAZ	1.4
2	SEKSION DY GJUHESH SHQIP-FRENGJISHT	1.4
3	SEKSION DY GJUHESH SHQIP-ITALISHT	1.4
4	SEKSION DY GJUHESH SHQIP-GJERMANISHT	1.4
5	GJIMNAZ ME KOHE TE SHKURTUAR	1
6	GJIMNAZ GJUHESOR	1
7	SHKOLLE ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	1
8	SHKOLLE SPORTIVE	1
9	SHKOLLE PEDAGOGJIKE	1
10	HOTELERI-TURIZEM	1
11	SHERBIME MJETESH TRANSPORT!	1
12	MEKANIKE	1
13	ELEKTROTEKNIKE	1

14	ELEKTRONIKE	1
15	PERPUNIM DRURI	1
16	NDERTIM	1
17	TEKSTIL-KONFEKSIONE	1
18	TEKNOLOGJI USHQIMORE	1
19	BUJQESI	1
20	SHERBIME SOCIALE DHE SHENDETESORE	1
21	VETERINARI	1
22	GJEODEZI	1
23	INSTALUES SISTEMEVE TERMOHIDRAULIKE	1
24	LLOGARI	1
25	SHERBIME BANKARE	1
26	ADMINISTRIM BIZNESI	1
27	RRJETE TE DHENASH	1
28	MBESHTETJE E PERDORUESVE TE TIK	1
29	ELEKTRONIKE NE TEKNOLOGJINE E AUTOMATIZIMIT	1
30	SILVIKULTURE	1
31	HARRY FULTZ, BIZNES	1
32	HARRY FULTZ, ELEKTRONIKE	1
33	HARRY FULTZ, AUTOMEKANIK	1
34	PETER MAHRINGER TEKNOLOGJI INFORMACIONI	1
35	PROFILE TE TJERA QE NUK JANI: TE LISTUARA	1

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ky vendim i përcillet për zbatim dhe publikim në faqen web të Institucionit, Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Ky vendim i përcillet për njohje MAS dhe QSHA.

KRYETARI I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA

